



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



| | | | |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Pritiheno/Prdato Received/Delivry | 16.05.2023 | 3 | viti god year |
| Organ / Njësia Organ./Jedinica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKMESHCK | 4263/2023 | | 113 |



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 496/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga; Eshref Shabani kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtar, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr. 496/2023, të datës 14.03.2023, të ankuesit

me adresë Komuna e Fushë Kosovës, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Menaxheri i Divizionit të Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Brendshme, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke nxjerr akt administrativ lidhur me shqyrtimin e kërkesës së datës 04.01.2023 të parashtruar nga ankuesi

II. Obligohet Sekretarja e Përgjithshëm e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Menaxheri i Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe që ti ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që zbatimi i këtij vendimi të bëhet brenda afatit të përcaktuar në pikën I të tij.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 14.03.2023, me numër protokoll 2605/2023, ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kompensimin e pagave lidhur me kompensimin e orëve shtesë, jashtë orarit të punës të punesa.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me vendim VK/2023, të datës 26.04.2023, ka shtyrë edhe për dhjetë (10) ditë afatin për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 496/2023, e datës 14.06.2023, me numër protokoll 2605/2023 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 01.12.2022; E- maili i datës 02.03.2023; E- maili i datës 08.12.2023; ; E- maili i datës 18.11.2023; E- maili i datës 05.08.2023; dëshmi për vijueshmëri nga data 01.11.2022, deri me datën 30.11.2022; Kërkesë e datës 04.01.2023; Formuari për punë jashtë orarit; Kërkesë e datës 02.02.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1.4 të Ligjit 06/L-048, për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar që ekziston baza ligjore për të vendosur, duke obliguar organin e punësimit, që ti ndërmarr të gjitha veprimet, që të bëjë shqyrtimin e kërkesës së datës 04.01.2023, të parashtruar nga nëpunësi civil

Bazuar në shkret e lendes se del së ankuesi me datë 04.01.2023, me numër protokoll 01/2023, ka parashtruar kërkesën për kompozimin e orëve jashtë orarit të punës, tek Menaxherit të Divizionit të Burimeve Njerëzore.

Kolegji i Këshillit lidhur me këtë çështje juridike-administrative, ju referuar dispozitave të Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 19, i cili përcakton se: *“Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave”*, Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë përkatësisht nenit 4 paragrafi 1, i cili përcakton se: *“Paga e nëpunësve civilë përbëhet nga paga bazë dhe nga shtesat mbi pagën bazë, të përcaktuara me këtë ligj”*, ndërsa referuar nenit 14 të këtij ligji, janë përcaktuar edhe llojet e shtesave që mund të aplikohen ndaj nëpunësve civil, ku përcaktohet se: *“Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut”*, ndërsa në mënyrë të hollësishme më akt nënligjor janë përcaktuar edhe mënyrat e realizimit të shtesave që derivojnë nga ky ligj, si rrjedhojë Rregullorja Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht neni 4 ka paraparë llojet e shtesave, ndërsa neni 5 i kësaj rregulloreje ka përcaktuar llojet e kompensimeve ndaj nëpunësve civil, po ashtu neni 10 dhe 11 i kësaj rregulloreje ka përcaktuar kushtet dhe planifikimi i buxhetit për pagesën e shtesave dhe kompensimeve respektivisht kompensimi për punë jashtë orarit. Po ashtu lidhur me këtë çështje Kolegji i Këshillit ju referuar Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë e cila në nenin 8 ka përcaktuar punë jashtë orarit dhe

mënyrat e kompensimit të tyre, ndërsa neni 56 i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, ka përcaktuar pagën shtesë për kujdestari, punë gjatë natës, punë jashtë orarit, punë gjatë ditëve të festave dhe punë gjatë fundjavës si dhe shumat në bazë të cilave mund të bëhet ky kompensim.

Kolegji i Këshillit, nisur nga provat e lëndës, vlerëson se ankuesi kanë ofruar dëshmi se ka kryer detyra të punës jashtë orari zyrtar të punës, rrjedhimisht në këtë pikëpamje Kolegji, vlerëson se Ministria e Punëve të Brendshme respektivisht Njësia e Burimeve Njerëzore ka qenë e obliguar që në pajtim me dispozitat e lartcekura dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative të shqyrtoj kërkesën e ankuesit duke nxjerr aktin administrativ përmes të cilit do të shqyrtoj në tersi pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruara përmes kërkesës së tij në pajtim me nenin 45 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 496/2023

Ruslita KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretares së Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK-së